



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**REKTORI**

Tiranë, më 15.01.2021

**N J O F T I M**

Mbështetur në Vendimin e Rektorit të datës 15.01.2021 “Mbi rishpalljen e konkursit për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **15.01.2021 deri më 21.01.2021**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialitetit ku aplikon.

**I. DEPARTAMENTI I ORGANIZIM DHE MENAXHIMIT.**

- **Metodologjia e Kërkimit Shkencor** (Mod. Statistikë e Aplikuar-SPSS )- **Bachelor**  
1 (një) Lektor, As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndën: Metodologjia e Kërkimit Shkencor (Mod. Statistikë e Aplikuar-SPSS janë si më poshtë:

**Kritere bazë**

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në fushat e Informatikës, Matematikë/Statistikë e aplikuar, Inxhinieri Kompjuterike, TIK, apo fusha të tjera të përafërta me to **(15 pikë)**
2. Për aplikantët me gradë Master i Shkencave:  
- Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze-me dëshmi) **(10 pikë)**

**Kritere preferenciale**

3. Preferohen aplikantët që kanë eksperiencë të mësimdhënies në IAL, preferohet në UST **(deri 20 pikë)**
4. Preferohen kandidatët që kanë grada dhe tituj **(15 pikë)**
5. Preferohen kandidatët që kanë marrë pjesë në projekte për zhvillim sistemesh informacioni/përpunimi të të dhënave **(deri 15 pikë)**
6. Vlerësohen kualifikime të ndryshme të detyrueshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës ku aplikojnë **(deri 10 pikë)**
7. Të ketë veprimtari shkencore si referime, botime ose studime. **(deri 15 pikë)**

- II. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shenuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, lëndën ku aplikojnë, dokumentacionin e mëposhtëm:
- ✓ Curriculum Vitae (e detyrueshme)
  - ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Bachelor (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
  - ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
  - ✓ Certifikatën e gradës “Doktor i Shkencave” (nqse ka) (fotokopje)
  - ✓ Dëshminë e titullit “Profesor i Asociuar” (nqse ka) (fotokopje)
  - ✓ Dëshminë e titullit “Profesor” (nqse ka) (fotokopje)
  - ✓ Fotokopje e kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
  - ✓ Dëshmi penaliteti (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
  - ✓ Numrin e llogarisë bankare (nqse ka) (fotokopje)
  - ✓ Vërtetim nga qendra e punës me lejen për t’u angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR – UST (nqse është i punësuar)
  - ✓ Vetëdeklarim në rast se është i/e papunësuar
  - ✓ Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).
- III. Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- IV. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.
- V. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

**REKTOR**

**Prof. Dr. Agron KASA**